
Analizë e Raportit Vjetor të Operatorit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2019

Analizë Politikash

/2020



Analizë e Raportit Vjetor të Operatorit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2019

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Prill 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	2
Përmbajtja dhe kualiteti i raportimit.....	2
Baza ligjore.....	3
Organizmi institucional.....	3
Kompensimi i bordit	4
Donacionet dhe sponsorimet.....	4
Projektet kapitale.....	5
Përfundime dhe Rekomandime	7

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2019. Puna e INDEP është mbështetur në parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe hulumtimit të pavarur.

Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “Kuvendi i fuqizuar për politika dhe ligjvënje efektive, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme”, e financuar nga NED (National Endowment for Democracy).

KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës) është kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore e cila sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmetimit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrejtin e shpërndarjes: 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV. Përgjegjësi e KOSTT është që të transmetojë energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

Rëndësia e këtij raporti qëndron në informimin e deputetëve dhe opinionit të gjerë me arritjet, ngjarjet, pasqyrën e performancave, operimin e tregut dhe transmetimit, progreset dhe ngecjet e kompanisë. Në këtë raport përfshihen edhe të dhënat rreth projekteve kapitale, politikat e personelit të KOSTT, sidhe sugjerimet dhe propozimet për rritjen e performancave.

Analiza e këtij raporti është e ndarë në disa pjesë. Pjesa e parë paraqet analizimin e përmbajtjes dhe kualitetit sa i përket mënyrës dhe gjuhës së përdorur gjatë raportimit. Kjo analizë përmbanë poashtu edhe të dhëna për bazat ligjore si kapitull në vete, në vazhdim analizohet edhe organizimi institucional i kësaj kompanie publike. Më pastaj flitet edhe për kompensimi e bordit dhe shpënzimin e parave publike, si temë goxha me rëndësi, sidhe për donacionet e sponsorisimet e bëra nga ana e kësaj kompanie publike. Në pjesën e fundit flitet për projektet kapitale të planifikuara dhe realizimin e tyre gjatë vitit 2019.

Përmbajtja dhe kualiteti i raportimit

Raportimi vazhdon të mbetet ende jo kontradiktor dhe jo i unifikuar. Kjo për faktin se ende pjesë të ndara ku njëra pjesë ka një raportim të Bordit të Drejtorëve dhe një tjetër nga Kryeshefi Ekzekutiv. Kjo mënyrë e raportimit është e papërshtatshme për të realizuar një informim të drejtë ndaj deputetëve të Kuvendit dhe opinionit të gjerë. Në raporte vjetore, duhet të ketë një përmbledhje të përgjithshme të punës gjatë vitit 2019 dhe jo një përmbledhje e pjesëve të ndryshme të raportimit.

Gjuha e raportit poashtu paraqet problem të cilin duhet përmirësuar në raportet e ardhshme. Kjo për vetë faktin së KOSTT përmes këtij raporti i drejtohet fillimisht deputetëve të kuvendit dhe opinionit të gjerë i cili jo domosdo ka njohuri rreth termave të përdorur. Gabimet teknike dhe tërmat shkencorë nuk janë lehtësisht të kuptueshëm për personat të cilët nuk i përkasin fushës së energjisë.

Baza ligjore

Duke e vazhduar trendin e viteve të kaluara, KOSTT edhe këtë vit ka raportuar për bazën ligjore në aneks të raportit. Përmes këtij listimi, KOSTT përsëri nuk i është përmbajtur manualit për raportim të agjencive të pavarura. Sipas manualit, baza ligjore duhet të radhitet e dyta sa i përket renditjes në raportin vjetor.

Në raport është cekur si nëntitull edhe “*Ndikimi i Ligjit të Energjisë Elektrike në KOSTT*”. Por, detajet sa i përket kësaj teme nuk i ka shpjeguar qartë se si ka ndikuar i Ligji i Energjisë Elektrike në KOSTT. Përmend vetëm se cili është qëllimi i Ligjit dhe vazhdon menjëherë me legjislacionet sekondare, aktet nënligjore dhe sfidat e KOSTT që lidhen me ligjin, pa e shtjelluar pjesën e ndikimit të Ligjit të Energjisë Elektrike në KOSTT.

Kjo paqartësi ka vazhuar edhe në raportin e auditorit të brendshëm. Për dallim prej raporteve të viteve tjera, në këtë raport përfshihet më gjerësisht procesi për menaxhimin e funksionimit të auditimit, mirëpo çfarë e lë ende të mangët këtë raport është pjesa e rekomandimeve. Në këtë pjesë thuhet se kanë qenë gjithsej 71 rekomandime të adresuara në departamente të ndryshme, mirëpo nuk jep detaje se çfarë kanë përmbajtur ato rekomandime.

KOSTT poashtu ka theksuar se tek ta mbetet sfida e ndjeshmë zbatimi i Ligjit të Pagave në Sektorin Publik. Sipas tyre “*KOSTT është angazhuar dhe do të angazhohet, duke shfrytëzuar të gjithë mekanizmat ligjorë për largim të KOSTT-it nga Ligji për Paga në Sektorin Publik*”, kështu sipas tyre, KOSTT duhet me çdo kusht të largohet nga Ligji për Paga. Edhe pse e kanë theksuar këtë si sfida, ata nuk arsyetojnë këtë veprim se sa dhe çfarë ndikimi ka ky ligj në punëtorët e KOSTT.

Organizmi institucional

Gjatë periudhës së hartimit të këtij raporti, KOSTT nuk ka pasur Bord të Drejtorëve të emëruar. Kjo pasi që mandati i Drejtorëve të Bordit të emëruar sipas Vendimit 07/47 të datës 02.09.2015 ka përfunduar me 2 shtator 2018. Në bazë të raportit të KOSTT, procesi i rekrutimit dhe emërimit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT është iniciuar nga Kuvendi i Kosovës, por asnjëherë nuk është përfunduar.

Kjo mungesë sipas raportit ka paraqitur vështirësi në realizimin e projekteve investive dhe zhvillimore të KOSTT. Kjo për faktin se KOSTT nuk ka pasur Plan të Biznesit dhe Buxhet të miratuar. Por edhe përkundër këtij fakti, kanë vazhduar iniciimin dhe realizimin e projekteve kyçe dhe të domosdoshme, siç thonë ata për të garantuar operimin e sigurtë të sistemit të transmetimit

dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për të ofruar shërbimet për përdoruesit e sistemit. Edhe pse e kanë theksuar se ka vështirësi në mungesë të bordit, ata nuk përmendin së në cilat projekte kanë hasur këto vështirësi.

Në raportin e këtij viti, KOSTT sqaron strukturën e bordit të KOSTT dhe e paraqet strukturën përmes diagramit. Poashtu, ky raport tregon edhe numrin e punëtorëve dhe tenton të sqarojë lëvizjen e numrit të punëtorëve nga 354 sa ishte në janar të vitit 2019 në 347 punëtor në dhjetor të vitit 2019, zvogëlim ky i cili nuk është i qartësuar. Raporti sqaron se prej 354 punëtorëve, 15 prej tyre janë pensionuar dhe dy kanë ndërruar jetë, mirëpo sipas raportit janë shtuar 30 punëtorë të rinjë, numër ky i cili nuk korrespondon me numrin total të punëtorëve të dhjetorit të vitit 2019. Pra, ky raport nuk është i qartë se çfarë ka ndodhur me numrin e punëtorëve.

Një çështje tjetër e cila duhet poashtu të diskutohet është edhe pjesa për trajnimin e personelit e cila paraqet disa mangësi sa i përket sqarimeve të detajizuara. Raporti përmend vetëm se është investuar në trajnimet profesionale të financuara nga buxheti i KOSTT për trajnime, të mbajtura nga vet stafi i KOSTT (165 ditë) dhe jashtë KOSTT-it (537 ditë), të kontraktuar nga qendrat trajnuese për vitin 2019. Mirëpo nuk e jep tabelën e detajizuar në lidhje me programet e trajnimeve dhe temave të shqyrtuara. Po ashtu, është e rëndësishme të pasqyrohet detajisht edhe ndikimi që e kanë këto trajnime në përmirësimin e performancës së stafit sidhe në arritjen e objektivave strategjike, pasi që përfundimisht, trajnimi i punonjësve realizohet me qëllim të arritjes së objektivave, mirëpo këtë pjesë ky raport nuk e ka cekur.

Raporti përmend edhe projektin i cili merret me angazhimin e gruas në sektorin e energjisë i përkrahur nga USAID. Bazuar në këtë raport, KOSTT përkrahë angazhimin e gruas në sektorin e energjisë, mirëpo bazuar në të dhënat e raportit, numri i grave të angazuara në sektorët e KOSTT, mbetet ende shumë i vogël. Prandaj parashtrohet pyetja se “cilat janë politikat e rekrutimit të KOSTT në kuptimin e barazisë gjinore?”.

Kompensimi i bordit

Vitin e kaluar si temë mjaft me rëndësi është shtjelluar edhe kompensimi i bordit. Në raport e vitit 2017 është përshkruar se secili anëtar i bordit, ka marrë shtesë nga mbi 4700 deri tek mbi 5500 euro shtesë për performancë të ndërmarrjes. Gjithashtu, edhe se bordi, merr edhe 90 euro kompensim për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për mbledhje sipas vendimit të Bordit nr. 161013–II/4/1. Këto të dhëna nuk figurojnë në raportin e vitit 2019. Prandaj nuk dihet nëse ky trend i pagesave shtesë dhe i kompensimeve ka vazhduar me të njëjtin ritëm edhe këtë vit.

Donacionet dhe sponsorimet

Sipas raportit të KOSTT, në shenjë solidarizimi dhe humanizmi kjo kompani ka realizuar një përkrahje financiare për të kontribuar në lehtësimin e pasojave nga tërmeti që ndodhi në fund të muajit nëntor në Republikën e Shqipërisë. Përderisa në këtë raport poashtu thuhet se gjatë vitit 2019, KOSTT nuk ka sponsorizuar dhe nuk ka pasur donacione, vlenë të shtrohet pyetja se në çfarë

formë është dërguar kjo përkrahje financiare. Në këtë pjesë mungojnë edhe të dhënat rreth shumës që është dhënë si kontribut për këtë çështje dhe prej cilit fond janë marrë këto para.

Kurse sa i përket sigurimit të financimeve të projekteve nga donatorët, KOSTT ka arritur të sigurojë financim në vlerë mbi 120mil euro dhe qasje në institucione kredibile financiare ndërkombëtare si KFË, BERZH. Këto donacione kryesisht janë investuar në ngritjen e kapaciteteve të rrjetit të transmetimit, pasi që siç theksohet në raport, në të kundërtën këto investime do të mbuloheshin nga tarifat e konsumatorëve.

Projektet kapitale

Në raportin e KOSTT është thënë se gjatë vitit 2019 nuk ka pasur projekte të reja dhe se ky vit karakterizohet si vit i vazhdimësisë së projekteve të filluara në vitet paraprake, të financuara nga BERZH përmes kredisë dhe buxhetit vetanak të KOSTT-it. Sa i përket mosfillimit të projekteve kapitale, KOSTT nuk jep detaje se përse nuk ka projekte të reja kapital epër këtë vit.

Megjithatë, edhe në implementim të projekteve ka pasur ngecje. Në disa prej projekteve, mosfillimin e punëve implementuese në teren me kohë e arsyetojnë me shkakun se lejet ndërtimore ka shkaktuar vonesa prandaj përfundimi i projekteve është zgjatur për një Afat deri në Q2 2020. Tabela në vijim tregon të dhënat rreth realizimit të projekteve kapitale gjatë vitit 2019.

Nr.	Emri i projektit	Financues	Vlera e kontratës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kontraktues	Buxheti i shpenzuar Gjatë vitit 2019
1	Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes KOSTT/KEDS	KOSTT	2,327,240.19€ pa TVSH 2,006,241.54 Dhe pas ndryshimit 1,986,705.25€	24.11.2014	12.08.2016 deri më 31.12.2018	Monten & G3 Inxhinering	52,278.96€
2	Shërbimet të Konsulencës për implementim e projekteve të financuara nga BERZH “Projektet e zhvillimit të Transmetimit të Kosovës“	BERZH/Kredi	825,464.62€ +314,084.00€ 1139545.62€	Q2 2016	Q2 2020	AF Consult Sëitlerland Ltd	220,032.23
3	Projektet me BERZH LOT 1 – nënstationet GIS No.45552	BERZH (kredi)/KOSTT	19,614,980.67€	16.09.2016	Q2 2019	ABB (Italy/Croatia)	3,502,060.38 €
4	Projektet me BERZH LOT 2 – transformatorët e fuqisë	BERZH (kredi)/KOSTT	3,880,401.28€	16.09.2016	Q2 2019	Hyundai/Balka n Petrol	1,247,540.70 €
5	Projektet me BERZH LOT 3 – Linjat transmetuese	BERZH/KOSTT	7,663,246.00€	03.10.2016	02.10.2018	Romelectro	931,159.04 €

Në raport përmendet se ky viti rezulton me nënshkrim e tri Marrëveshjeve të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit, mirëpo nuk jep informata të detajizuara në lidhje me marrëveshjet. Thekson

gjithashtu se gjatë këtij viti është përgatitur edhe draft Specifikimi teknik për NS 110/35/10kV Ferizaj3(Kastrioti) por pa më shumë detaje rreth këtij drafti.

Në këtë raport, thuhet se pavarësisht se Ligji për sigurimet shëndetësor ende nuk është implementuar, projektet për shëndetin e punëtorëve janë realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët edhe gjatë vitit 2019 por nuk e sqaron se çka ka përbajtur në vete ky orjekt dhe sa ka qenë i suksesshëm në mbrojtjen e punëtorëve dhe sa ka ndikuar ky projekt në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë.

Një temë tjetër të cilën e nuk e shtjellojnë sa duhet është edhe humbjet nga veriu i Mitrovicës. Ky raport duhet të japë informata të hollësishme në lidhje me humbjet e shkaktuara si rezultat i mpagesave të tatimeve nga ana e qytetarëve që jetojnë në atë pjesë.

Përfundime dhe Rekomandime

Raporti i këtij viti në disa pjesë përfshinë informacione më të detajizuara sesa vitet e tjera. Gjuha si në lëshimet teknike, ashtu edhe në përdorimin e termave vështirë të kuptueshëm ende mbetet problem madhor për personat të cilët nuk kanë prapavijë në fushën e energjisë. Gjuha sa më e kuptueshme dhe përfshirja e plotë në informim duhet të jetë paësore në raportet e ardhshme. Gjithashtu, raporti ka diversifikim të raporteve, ku nuk përcatohet në njërin raportim, por ndodhen pjesë të raporteve të bashkuara nga kryeshefi ekzekutiv dhe nga kryesuesi i Bordit të drejtorëve.

Sa i përket bazave ligjore, vërehet një përmirësim në zbatimin e Manualit për Raportim të Agjenciv dhe Institucioneve të Pavarura me Kuvendin e Kosovës për dallim nga vitet e kaluara. Megjithatë, disa pjesë ende mbesin të parenditura sipas kërkesave të manualit. Baza ligjore është diskutuar tek në Aneksi i raportit dhe nuk ka pasur shpjegime të hollësishme për ndikimin e Ligjit të Energjisë Elektrike në KOSTT. E njëjta gjë vlenë edhe për Ligjin e Pagave ku KOSTT me ngulim thekson se duhet të largohet nga ky ligj si kompani, por që nuk e detajizon arsyen se pse. Për më tepër, KOSTT nuk jep informacione të hollësishme rreth rekomandimeve të marra nga Auditori i Brendshëm.

Tek pjesa ku flitet për organizimin institucional, KOSTT nuk raporton qartë për numrin e saktë të punëtorëve. Kështu që numri paraprak i punëtorëve të muajit janar 2019 mos të përshtatet me numrin e punëtorëve të muajit dhjetor duke përfshirë numrin e punëtorëve të pensionuar dhe atyre të vdekur me numrin e punëtorëve të rinjë. KOSTT nuk e jep arsyen se përse ka qenë e nevojshme të rritet numri i punëtorëve të rinjë dhe se në cilët sektorë ka qenë e nevojshme ky shtim i stafit. Kurse tek pjesa e trajnimeve, tregohet numri i trajnimeve dhe numri i pjesëmarrësve, kurse nuk ka të dhëna rreth trajnimeve të ndjekura dhe kostove të këtyre trajnimeve.

Për kompensimet shpesh të anëtarëve të bordit për këtë vit nuk ka kurrfar informate. Për INDEP, është detyrë edhe e Komisionit funksional, krahas atyre për Buxhet dhe Mbikëqyrje të Financave Publike që të sigurohen informata rreth këtyre kompensimeve për këtë vit, në mënyrë që të verifikohet se a ka ndodhur përsëri shpenzimi i parasë publike. Këto të dhëna nuk figurojnë askund në këtë raport.

Pasiqë KOSTT nuk ka filluar projekte të reja kapitale në vitin 2019, duhet të jepen sqarime më të hollësishme rreth kësaj teme. Për më tepër, në raport shkruan se nuk ka pasur donacione dhe sponsorime. Mbështetja financiare të cilën KOSTT e ka dhënë në shenjë solidarizimi dhe humanizimi si shkak i tërmetit në Shqipëri, duhet të këte informata në lidhje me burimin e financimit dhe shumën e dhëtnë. Këto nuk janë të paraqitura në raport.